



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Procesi - Projeçta - Në Dazë 15-03-2010			
№ i organit Org. org.	Numri/Broj	Shtojcë Prilog	Vlera vrenoset
	01-013/884 -		



Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 17 pika c) dhe nenit 40.2 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr 03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta zyrtare nr 28/2008, dhe nenit 5.1 pika c) të Statutit të Komunës së Vitisë nr 013/5165 të datës 18.11.2008 Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më 05 mars 2010 aprovon këtë:

## V E N D I M

### PËR ÇAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT TË ADMINISTRATËS KOMUNALE

#### Neni 1

APROVOHET Vendimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të administratës komunale në Viti.

Lokacioni për ndërtimin e objektit të administratës komunale caktohet në pronën komunale në ngastrën/njësinë kadastrale nr 3397/10 në sipërfaqe prej 5450 m<sup>2</sup>, Zona kadastrave Viti.

#### Neni 2

Mjetet financiare për ndërtimin e këtij objekti do të siguroj Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal së bashku me Komisionin Evropian.

Komuna e Vitisë do ta caktoj dhe rregulloj lokacionin, mbikëqyrjen e ndërtimit dhe ofrimin e ndihmës profesionale, duke angazhuar ekspert profesional të lëmive përkatëse.

#### Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për, Kadastër Gjeodezi dhe Pronë e Komunës së Vitisë.

#### Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Vitisë.

01. Nr \_\_\_\_\_  
Viti, 15 mars 2010

KRYETARI I KUVENDIT  
Skenderbeu Hebib

